



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17, shkronja b), nenit 40, shkronja l), të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2.5 dhe nenit 17 paragrafi 1 të Ligjit 04/L-174 për Planifikim hapësinor, Udhëzimi administrativ MMPH- nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme dhe Udhëzimit administrativ MMPH- nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe të nenit 15, paragrafi 15.1 shkronja b), nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja b) dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR FILLIMIN E REVIDIMIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM
"LAKËRISHTA" PËR BLOKUN "A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8" NË PRISHTINË

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Lakërishta", për bllokun "A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8", në Prishtinë.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, si çështje e përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

Neni 3

Qëllimi i revidimit

Me miratimin e Planit rregullues të hollësishëm nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe me mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4
Kufiri i territorit

Territori i Planit rregullues të hollësishëm për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm “Lakërishta”, për bllokun “A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8”, në Prishtinë, përfshin sipërfaqe prej S= 7.4 ha.

Neni 5
Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit është Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës.

Neni 6
Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për revidim

Mjetet për revidimin e dokumentit të planifikimit hapësinor, janë të siguruara nga buxheti i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës.

Neni 7
Afati i revidimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta revidojë në afat për 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 8
Konsultimet publike

Para finalizimit, propozimi për revidimin e Planit rregullues të hollësishëm, do të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Propozim-planit rregullues të hollësishëm në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve, do të shpallen përmes njoftimeve publike, konform nenit 8 të Udhëzimit administrativ, nr. 05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, ku shqyrtimi publik do të zgjatë 15 ditë.

Neni 9
Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhe 8-vjeçare.

Neni 10
Gjuha zyrtare

Plani rregullues i hollësishëm sipas pikës 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11
Programi

Pjese e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 3 e Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174.

Neni 12
Hyrja ne fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-350/05-215668/23, më 03.11.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Fëllumb Bajtinovci



ARSYETIM

i Vendimit për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Lakërishta", për bllokun "A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8", në Prishtinë.

Hyrje

Duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174, dhe në kërkesën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe kërkesat e vazhdueshme të qytetarëve për të investuar në këtë zonë, Komuna e Prishtinës do të formojë grupin punues, me përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe drejtoritë tjera përgjegjëse, për analizë të zonës në fjalë, për inicim të procesit të hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për Zonën e lagjes "Lakërishta", në Prishtinë, plan i cili është miratuar fillimisht me Vendimin e Kuvendit komunal qysh në vitin 2007.

Inicimi i tillë është bërë bazuar edhe në komunikimet paraprake me MMPH-në, përkatësisht në përgjigjen e MMPH-së, nr. 4724/18, të dt. 21.09.2018, ku thuhet se Komuna mund të hartojë plane rregulluese të hollësishme (rasti "Dodona", blloku "A-1"), pasi që Udhëzimi administrativ i MMPH-së, nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, ka hyrë në fuqi, më 14.2.2018, dhe se Komuna duhet të bazohet në dokumentin e Planifikimit hapësinor, Planin zhvillimor komunal të Komunës në fuqi, dhe sipas Udhëzimit administrativ të MMPH-së, nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor (neni 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe nënparagrafi 1.6. i Ligjit).

Fushëveprimi

Plani rregullues i hollësishëm do të përcaktojë kushtet ndërtimore sipas Ligjit për planifikim hapësinor nr. 04/L-174, Udhëzimi administrativ MMPH-nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme dhe Udhëzimit administrativ MMPH-nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe ligjeve të tjera në fuqi. **Sipas Planit zhvillimor komunal dhe Planit rregullues "Lakërishta", aktual, kjo zonë është e destinuar si zonë ekzistuese urbane.**

Qëllimi

Duke u bazuar në gjendjen faktike në terren dhe trendin e zhvillimeve që kanë ndodhur që nga miratimi i Planit rregullues "Lakërishta" në vitin 2007, Komuna e Prishtinës në bashkëbisedim me qytetarët e kësaj lagjeje, e shohin të nevojshëm revidimin e pjesshëm të Planit rregullues, me qëllim të realizimit të interesit publik, të cilat Komuna e Prishtinës i sheh si shumë të rëndësishme jo vetëm për lagjen "Lakërishta", por edhe më gjerë.

Me miratimin e Planit, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, qëllimi i revidimit i kësaj pjese të planit, ka të bëjë me harmonizimin e infrastrukturës rrugore ekzistuese me atë të planifikuar me Vendimin nr. 01-110-12050, dt. 29.3.2012.

Plani do të adresojë çështje me qëllim të orientimit të investimeve publike dhe private, rigjallërimin e zonës, zhvillimin ekonomik, çështjet mjedisore etj. Komuna e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes "Lakërishta", i cili plan do të inkorporohet më pas në Hartën zonale të Komunës së Prishtinës.

Ky plan do të mbulojë një periudhë së paku 8-vjeçare dhe ndryshimi i tij do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Kufiri i sipërfaqes së planifikuar

Zona për të cilën do të hartohet revidimi i Planit rregullues të hollësishëm, përfshinë sipërfaqe prej $S = 7.4$ ha. Revidimi i Planit rregullues të hollësishëm do të caktojë kushtet ndërtimore sipas Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174, UA MMPH 08/2017, për normat teknike, për planifikim hapësinor dhe UA MMPH 01/18, për elementet dhe Kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme.


Projektplani rregullues i hollësishëm para finalizimit, duke u bazuar në nenin 7, pika 2, të Udhëzimit administrativ për përgjegjësitë e autoritetit të planifikimit hapësinor, si dhe Parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nr. 05/2014, dhe sipas nenit 8, pika 4 të këtij udhëzimi.

Komuna do të publikojë projektin në dispozicion të publikut, grupeve të interesit, departamenteve dhe agjencive të tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim, dhe kjo periudhe do të zgjatë 15 ditë.

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik, duke u bazuar në nenin 11, pikën 1.6.1 të Ligjit nr. 04/L-174, do ta menaxhojë procesin e hartimit të Planit përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda Komunës.



2. Kufiri i planit aktual "Lakërishta".



3. Kufiri i propozuar për PRRH "Lakërishta".



4. Kufiri i planit në raport me PZHK-në.

